



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 69/16
Prishtinë, më 7.10.2016, ora 22:45
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Shukri Buja, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Shqipe Pantina, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Jelena Bontić.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Kransiqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-119 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-120 për Trepçën dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktura, Tregti dhe Industri;**
- 1. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-119 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike;**

Kryetari – theksoi se në mbledhjen e kaluar të komisionit, me procedurë të jashtëzakonshme e kemi shqyrtuar dhe përkrahur në parim Projektligjin nr.05/L-119 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike dhe kemi kërkuar që të shqyrtohet në seancën plenare të datës 29.9.2016, me shmangje të Rregullores. Por, meqë Projektligji nuk e ka pasur të bashkangjitur shkresën përcjellëse me të cilën ngarkohemi si komision funksional për të shqyrtuar në parim, e cila është bërë në ndërkohë, dhe për shkaqe procedurale nuk ka mundur të radhitet për shqyrtim në Kuvend. Pra nuk ka ndryshime dhe arsyetime tjera dhe propozojë që t'i rekomandojmë Kuvendit për miratim në lexim të parë.

Pas sqarime dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.05/L-119 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike.

2. Shqyrtimi Projektligjin nr.05/L-120 për Trepçën dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktura, Tregti dhe Industri

Kryetari – theksoi se Projektligji dhe amendamentet e komisionit nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.05/L-120 për Trepçën dhe amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktura, Tregti dhe Industri, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Mbledhja përfundoi në ora 23:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani